

Per nje perdorues qe ka inters.

Pershendetje.

Para disa kohesh, per nje rast, kur shoqeria ne kushte apsolutisht te domosdoshme, eshte detyruar te marre, per ngarkim shkarkim, puntore te çasit, por qe jane kapur nga organet tatimore dhe jane penalizuar per mos deklarim punonjesish; pergatita montazhin ligjor te me poshem me bindjen qe penalizimi per kete rast eshte i gabuar.

Nisur nga disa pyetje e kerkesa te bera se fundmi, mendova, se paraqet interes, edhe per me gjere.

Gjykimi eshte i gjithesejcilit.

Ne Vijim:

1. Ligji 8438, Datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të ardhurat
2. Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 Për Tatimin mbi të ardhurat
3. Ligji 9920, datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në RSH
4. Udhëzim Nr.24, datë 02.09.2008 Për Procedurat Tatimore në RSH
5. Ligji 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i RSH
6. ligji 9901, datë 14.4.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare
7. Statuti

Ligji 8438, Datë 28.12.1998
Për Tatimin mbi të ardhurat

Kreu II Tatimi mbi te Ardhurat Personale

Neni 8 E ardhura e tatueshme

1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:

g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

Udhezimi Nr.5, datë 30.01.2006
Për Tatimin mbi të ardhurat

2.3. Të Ardhurat e Tatueshme

Në zbatim të Nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:

2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g).

.....

Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore **(dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore).**

Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme te biznesit.

.....

Edhe në rastet kur pagesi i të ardhurës është person juridik apo fizik i regjistruar në organet tatimore shqiptare ose çdo ent, organizatë joqeveritare, apo organ i qeverisjes qendrore apo vendore në Shqipëri, apo përfaqesi e organizmave ndërkombëtare apo ambasadë e huaj në Shqipëri, tatimi **mbahet në burim në masën 15% të pagesës dhe derdhet në organin tatimor përkatës brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.**

Ligji 9920, datë 19.5.2008
Për Procedurat Tatimore në RSH

Neni 53

Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi

1. Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi, për çdo rast të tillë, shënon në faturë edhe numrin e tij të identifikimit.

Udhëzim Nr.24, datë 02.09.2008
Për Procedurat Tatimore në RSH

53. Faturat tatimore të përgatitura nga blerësi

53.1 Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Fatura e përdorur në këtë rast është fatura tatimore me numër serial që blerësi subjekt tregtar përdor në aktivitetin e tij.

Personi i tatueshëm si marres i furnizimit është i detyruar që të shënojë në faturën e përgatitur për veten e tij të dhënat identifikuese të shitësit. Fatura e

lëshuar si me sipër nga vete blerësi, person i tatueshëm është një dokument që justifikon shpenzimet e zbritshme të biznesit për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin.

P.sh. një tatimpagues grumbullues produktesh bujqësore blen produkte bujqësore apo blektorale nga fermerë të vegjël të pa regjistruar në tatime. Në këtë rast blerësi përpilon një faturë ku figuron si blerës dhe ku vendos të dhënat identifikuese të shitësit individ dhe sasinë dhe vleftën e mallit të blerë prej tij. Për këtë qëllim mund të shërbejë, sipas rastit, fatura tatimore me TVSh ose fatura e thjeshtë tatimore, të cilat tatimpaguesi i përdor normalisht në biznesin e tij në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këto fatura shënohet gjithashtu në një vend të dukshëm "Faturë e lëshuar nga blerësi".

Po kështu, një shoqëri tregtare paguan një individ vendas ose të huaj (që nuk është i regjistruar në organet tatimore shqiptare) për një shërbim rastësor konsulence, përkthimi, etj., Në këtë rast shoqëria përfituese e shërbimit përpilon një faturë, e cila përfshirë shënimin "Faturë e lëshuar nga blerësi", të dhënat identifikuese të individit shitës të shërbimit, vleftën e shërbimit dhe tatimin që mbahet në burim të llogaritur për pagesën e këtij shërbimi.

Ligji 7961, datë 12.7.1995

**KODI I PUNËS I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
KREU V PUNA ME KOHË TË PJESSHME**

Neni 14

1) Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë pune, për një kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte.

**Ligji 9901, datë 14.4.2008
PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE**

Neni 81 Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

S T A T U T I

Neni _____

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
